

Hapet thirrja për aplikime për stafin e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Nysës, në Poloni, në Kuadër të Programit Erasmus +, për mësimdhënie dhe trajnim, për semestrin e dytë të vitit akademik 2020-2021.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Nysës, në Poloni, për mësimdhënie dhe trajnim, për semestrin e dytë të vitit akademik 2020-2021.

<https://www.pwsz.nysa.pl/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit për mësimdhënie;
- Shkëmbimin e stafit për trajnim.

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 ditë + 2 ditë udhëtim;

Fushat e mësimdhënies për stafin akademik:

- Administrim Biznesi;
- Gjuhë e huaj;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik për mësimdhënie:

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj;
- Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo/jeni shpallur më parë një mobilitet Erasmus+ (nëse po, ku);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing-1-1.docx

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për trajnim klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Training_outgoing-1.docx

*Plani i Mobilitetit për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Afati për aplikim: 20 Dhjetor 2020.

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara në postë elektronike në adresën iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!